



KOMUNIKATË

22.12.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur sot, në rend dite pati shqyrtimin e përgjigjes së KAZAP-it lidhur me shpjegimet shtesë për vendimin udhëzues që KQZ të urdhëroj përsëritjen e votimeve në komunat: Prizren, Lipjan dhe Gjilan.

Kryetarja e KQZ-së, znj. Nesrin Lushta, u kërkoi anëtarëve të KQZ-së mënyrën se si do të procedohet vendimi i KZAP-it. Anëtarët e KQZ vendosën që shqyrtimi të procedohet komunë për komunë dhe, jo në paket. KQZ vendosi kështu sepse, edhe KZAP-i e kishte proceduar vendimin e tij, veq e veq.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mori vendim që në komunën e Prizrenit të përsëriten votimet. Vendimi u mor me 8 vota për, 2 kundër dhe 1 apstenim. Për komunën e Gjilanit, vendimi u mor që të mos shkohet në përsëritje të votimit por KQZ të hetoj dhe rinumëroj votat në QNR dhe pastaj, të vendos për nevojën e rivotimit në këtë komunë. Vendimi, u mor me 6 vota për, 2 vota kundër dhe, 3 apstenime. KQZ vendosi që edhe në komunën e Lipjanit, të përsëriten votimet. Ky vendim u mor me 8 vota për, 2 vota kundër dhe, 1 apstenim.

KQZ ka autorizuar Sekretariatit e KQZ-së që të filloj përgatitjet për organizimin e përsëritjes së votimeve në Prizren dhe Lipjan, si dhe për hetimin dhe rinumërimin e votave në komunën e Gjilanit.